



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr.____ Prot

Shkodër, më _____.____.2025

Lënda: Kthim përgjigje shkresës suaj

Në përgjigje të shkresës suaj me lëndë “ Kërkesë për informacion”, datë 24.03.2025, administruar pranë Bashkisë Shkodër, me nr.6587 prot, datë 26.03.2025, pas shqyrtimit të kërkesës tuaj dhe në zbatim të dispozitave të parashikuara në ligjin nr.139/2015”Për Veteqeverisjen Vendore”, I ndryshuar; ligjin nr.119/2014, datë18.09.2014 ”Për të drejtën e informimit”, ju informojmë se:

- Bashkia Shkodër nuk ka përfunduar akoma procesin e regjistrimit të pronave të bashkisë, referuar dispozitave të ligjit 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë" dhe VKM-së nr.28, datë 27.1.2023 "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve" vazhdon procesi i inventarizimi dhe përditësimi i pronave në të gjithë territorin pasi me bashkimin e ndodhur nga Reforma Territoriale e vitit 2015 Bashkisë Shkodër i janë bashkuar 10 Njësi Administrative disa nga të cilat nuk kanë pasur lista inventarësh te miratuar.
- Bashkia Shkodër nuk ka marrë asnjë ambient me qira me qëllim ushtrimin e funksioneve administrative.
- Në lidhje me pikën nëse kemi aplikuar taksën e 3%, në zbatim të nenit 19 “Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik”, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar si dhe Vendimit nr. 325 datë 29.05.2024 “Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale”, ju bëjmë me dije se:
- Sa i përket banesave sociale që disponojmë në sipërfaqe takuese, kemi vetëm një njësi banimi me sip. 80 (tetëdhjetë) m2 e cila sipas dispozitave të aktmarrëveshjes me subjektin ndërtues, parashikohet që apartamenti i banimit do të kalojë në favorin e fondit të banesave sociale, Bashkia Shkodër pas regjistrimit përfundimtar të objektit pranë ASHK-së, Drejtoria Vendore Shkodër.
- Në lidhje me fondin e mbajtur në formë monetare ekuivalente për sipërfaqe takuese, e cila kalon në llogarinë e posaçme të Bashkisë Shkodër, në favor të fondit të banesave sociale, vlera totale e mbledhur deri më sot rezulton të jetë 35,529,640 lekë.

- Me këtë fond parashikohet të kryhet Rikonstruksioni i Ish-Konviktit të Shkollës Veterinare, Shtesë Kati II, I cili ka fushe perdorimi sociale.
Për realizimin e këtij projekti, fondit të mësipërm do t'i bashkohet edhe vlera që është parashikuar të arkëtohet si e ardhur, referuar vlerësimit të bërë nga Drejtoria e Kontrollit të zhvillimit të Territorit, Bashkia Shkodër, mbi ndertimet që parashikohen të bëhen në territorin e bashkisë për vitin 2025.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR
Benet Beci